

Tirane me 22.07.2016

Drejtuar: AKM-Tirane

Per Dijeni: DRM-Tirane

BASHKISE TIRANE

**LENDA: KERKESE PER PJESEMARRJE NE
ORGANIZIMIN E KONSULTIMIT ME PUBLIKUN DHE
PALET E INTERESUARA PER APLIKIMIN PER LEJE
MJEDISI TE TIPIT B:**

TRAJTIMET ME REGJIE DHE PRODHIMI I LËKURËS

ID 7.6,

a. RREGJIA E LËKURËVE TË PAPUNUARA DHE SHOLLAVE
KAPACITETI PËRPUNUES ËSHTË I BARABARTË ME 12 TON/DITË PRODUKT
TË PËRFUNDUAR OSE MË PAK SE KAQ

**GRUMBULLIM, MAGAZINIM DHE TREGTIM TË
LEKURAVE TË BAGËTIVE**

PERSONI JURIDIK "VIGA"

**ADRESA : TIRANE, NJESIA BASHKIAKE NR.4,
RRUGA SELAUDIN BEKTESHI, NDERTESE NJE
KATESHE, ZONA KADASTRALE 8120, PASURIA
NR.1/139, BASHKIA TIRANE, QARKU TIRANES**

TIRANE 2016

AKTIVITETI: TRAJTIMET ME REGJIE DHE PRODHIMI I LËKURËS

a. RREGJIA E LËKURËVE TË PAPUNUARA DHE SHOLLAVE

KAPACITETI PËRPUNUES ËSHTË I BARABARTË ME 12 TON/DITË PRODUKT TË PËRFUNDUAR OSE MË PAK SE KAQ

GRUMBULLIM, MAGAZINIM DHE TREGTIM TË LEKURAVE TË BAGËTIVE

ZONA NË TË CILËN NDODHET GRUMBULLIM, MAGAZINIM DHE TREGTIM TË LEKURAVE TË BAGËTIVE ESHTË NE TIRANE, NJESIA BASHKIAKE NR.4, RRUGA SELAUDIN BEKTESHI, NDERTESE NJE KATESHE, ZONA KADASTRALE 8120, PASURIA NR.1/139, QARKU TIRANES. GRUMBULLIM, MAGAZINIM DHE TREGTIM TË LEKURAVE TË BAGËTIVE ËSHTË HAPESIRE E NEVOJSHME PER USHTRIMIN E KETIJ AKTIVITETI ME NJE KAT.

Duhet theksuar qe subjekti ka disa kohe qe e ushtron kete aktivitet ne kete magazine dhe nuk ka patur asnjehere probleme me komunitetin dhe sipermarresit e zones.

Ne te operojne teknologjia dhe instalimet perkatese, ambjentet e sherbimeve mbeshtetese dhe parkimi.

Sipas natyres se operacioneve qe realizojne teknologjia e projektit perbehet nga:

1. Tavoline pune
2. Magazina
3. Njesi te sherbimeve mbeshtetese

Objekt i punes i Shoqerise "VIGA" Shpk ne Magazinen e Grumbullimit te lekurave per eksport do te jene lekurat e bagetive te meposhtme:

- Delet.
- Vicat.
- Lopet.

PROCESI PRODHIMIT DHE KARAKTERISTIKA TE TIJ

Shoqeria “VIGA” Shpk ushtron aktivitetin e Grumbullimit dhe shitjes se lekurave te bagetive, importin dhe eksportin e tyre, duhet theksuar Jo-rregjie e lekurave, vetem grumbullim lekurash bagetish. Magazina per Grumbullimin e lekurave eshte brenda parametrave Europiane, ndodhet ne Tirane, NJESIA BASHKIAKE NR.4, RRUGA SELAUDIN BEKTESHI, NDERTESE NJE KATESHE, ZONA KADASTRALE 8120, PASURIA NR.1/139, Qarku Tiranes. Shoqeria ‘Viga’ Shpk ka zyrat dhe magazinën e grumbullimit te lekurave ne nje godine me 1 kate me siperfaqe totale prej 258 m² e cila sherben si ambiente pune dhe zyra ne sherbim te aktivitetit, kjo godine eshte marre me qera dhe ndodhet ne nje zone industriale.

Synimi i firmes eshte rritja e volumit te punes dhe shtimin e fuqise punetore per te punesuar persona nga zonave te tjera te Tiranes ku ndjehet mungesa e vendeve te punes.

Pershkrimi i parametrave kryesore te aktivitetit:

Shoqeria “VIGA” Shpk mbledh nga thertoret ne qarkun e Tiranes dhe rretheve te tjera lekurat e bagetive, kryesisht lekurat e Vicit. Lekurat e bagetive te mbledhura hapen ne nje vaske dhe aty ato kriposen me kripe deti dhe lihen aty derisa e thithin kripen dhe behet ne kete menyre tharja e lekures se bagetive. Lekurat e Thara paketohen, dhe dergohen per eksport. Pas tharjes se Lekurave te bagetive, ambienti lahet dhe pastrohet ne menyre sistematike me solucione te posateshme qe nuk ndikojne ne shendet dhe ne mjedis, dhe ujerat mblidhen ne gropen septike te magazines. Tualeti pastrohen jo me pak se dy here ne dite dhe ne raste te vecanta me shume, dhe mbas cdo pastrimi behet dizifektimi i saj. Ndonje mbetje qe ka si copa lekure ose leshi bagetish cohen nga subjekti ne vend depozitimin e mbetjeve urbane te caktuar nga bashkia Tiranes, duhet theksuar **qe nuk ka perpunim ose regjie lekure**, por vetem grumbullim lekurash bagetish per eksport, pra sic shikohet nga aktiviteti nuk ka asnje lloj ndotje te mjedisit. Numri i punonjesve eshte tre te perhershem dhe punetore sezonal sipas nevojave.

Veprimtaria ushtrohet brenda nje siperfaqe te kufizuar dhe ne nje zone pa vlera te

vecanta pejsazhere

Gjate ushtrimit te veprimtarise nuk ka emetime pluhrash por vetem emetime zhurmash. Keto emetime jane te kufizuara ne kohe dhe hapesire.

Cdo punetor eshte i veshur me uniforme dhe eshte i pajisur me maske dhe syze plastike te tejdukshme.

I gjithe procesi i teknologjik eshte i thate, pra nuk ka nevojte perdorimin e ujit teknologjik.

Sic shikohet gjate procesit teknologjik nuk ka asnje shkarkim ne ajer dhe asnje shkarkim ne uje.

Masa zbutese per parandalimin e ndotjes dhe aksidenteve me pasoja negative ne mjedis

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri.

- Ky eshte nje aspekt te cilit i eshte kushtuar vemendje e vecante nga investitori dhe projektueset sepse pervec rreziqeve dhe humbjeve te vlerave ekonomike per shoqerine ai eshte teper i rendesishem edhe per sigurine sociale dhe mjedisore.

Sigurimi i jetes se punetoreve dhe mbrojtja nga zjarri realizohet nepermjet nje sere pajisjesh dhe mjetesh te cilat garantojne neutralizim te shpejte te cdo zjarri te shkaktuar ne ambjentetet e tokes. Sistemi i mbrojtjes nga zjarri mund te kategorizohet ne dy njesi funksionale paisjesh dhe instalimesh:

1 – Njesia qendrore e parandalimit dhe shtypjes se elementeve zjarr – venese nepermjet nje sistemi qendror komandues i cili mbeshtetet ne nje depozite uji dhe sistem tubash me presion.

2 – Njesia e mjeteve te nderhyrjes dhe neutralizimit te perhapjes se zjarrit (njefikse zjarri e levizshme me shkume 10 lt dhe 1 fikse 7 lt) te vendosura ne disa pika ne ambjentetet e magazines.

I gjithë personeli që do të punesohet në ambientet e magazines trajnohet nga specialistet perkates të subjektit për menyrën e veprimit në rast aksidentesh, kordinimit të operacioneve dhe nderhyrjes efikase.

Në përpilimin e Planit të Menaxhimit dhe analizimin e tij është vërejtur se realizimi me sukses i këtij plani sjell një sërë përfitimesh për shoqërinë e tillë si:

- ushtrimi i veprimtarisë në përputhje me ligjet dhe rregulloret
- rritja e besimit të subjektit në partneret dhe klientet e saj
- marrëdhënie të mira me publikun dhe ambientalistet
- shmangia e penaliteteve nga organet e kontrollit të mjedisit, etj.

Me këtë raport sigurojmë organet përkatëse shtetërore, vendim – marrëse, se projekti i zbatimit dhe teknologjia e projektuar është bashkëkohore, cilësore dhe plotëson standartet e vendosura nga Bashkimi Evropian.

Aktiviteti jone ka bërë të mundur zbutjen e papunesisë në këto zone, duke bërë punësuar një pjesë të mirë të banorëve të kësaj zone.

Nga pikpamja sociale, zhvillimi i këtij aktiviteti është faktor për zbutjen e papunesisë dhe burim të ardhurash për familjet që jetojnë duke punuar në këto shoqëri.

Ndikimet në mjedis

Ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi:

- Nuk ka prodhim të mbetjeve të rrezikshme
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në ndryshimin e nivelit të ujërave tokësore, në rrugët ujore dhe në nivelin hidrostatik të ujërave nëntokësore, pasi në këtë zonë ku ndodhet objekti dhe përreth tij nuk ka burime ujore nëntokësore dhe shpime të ndryshme hidrogeologjike që do të mund të dëmtoheshin nga ky aktivitet.
- Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta.
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në cilësinë e ajrit të zonës, pasi nuk do të ketë shkarkime në ajër të gazrave, pluhurave apo tymrave.

- Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë emetime të ndryshme kimike të llojeve të ndryshme.
- Nuk parashikohen dëmtime të florës dhe faunës së zonës.
- Zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës sanitare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth.
Niveli i zhurmes nuk i kalon 55-70 dB(A) gjate punes ne kete magazine. Ky nivel zhurmash është brenda normave dhe nuk ndikon në shëndetin e punonjësve.
- Ka vlera normale të temperaturës dhe të lagështisë në mjediset e punës
- Janë marrë të gjitha masat për mbrojtjen në punë nga aksidentet dhe për evitimin e rrezikut nga zjarri.
- Fenomene të tjera. Vibracioni, nxehtësia, radiacioni, ndriçimi verbues etj. nuk janë të pranishme.
- Trafiku rrugor. Gjatë këtij aktiviteti nuk do të ketë ndikime në aktivitetin rrugor.
- Projektet e tjera si: rrugët e reja, kanalet e ujrave të zeza, banesat, linja të energjisë, naftë dhe gazsjellës, linja të telekomunikacionit etj. nuk do të ndikohen nga aktiviteti i mobilerise.

Masat mbrojtëse për punonjësit

Punëtorët janë të pajisur me librezat shëndetësore përkatëse.

Mbrojtja në punë dhe ruajtja e shëndetit të punonjësve që punojnë në magazinën e perpunimit te ullirit realizohet duke zbatuar:

- Rregulloren e sigurimit teknik
- Normativat e ndotësve në mjediset e punës të miratuara nga Inspektorati i Higjenës së Punës

Fasilitete

Në ambjentet e punes kemi edhe një sistem bashkëkohor ajrimi, për t'i mbajtur ambjentet e brendshme të godinës në një temperaturë optimale.

Konkluzione

Personi Juridik VIGA do ta ushtrojë veprimtarinë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe do të investojë për përmirësimin e mjedisit, punës dhe do të mirëpresë çdo sygjerim në të mirë të cilësisë së punës, si dhe aktiviteti do të bëjë të mundur zbutjen e papunësisë në këtë zonë, duke punësuar një pjesë të mirë të banorëve të kësaj zone.

Aktiviteti: GRUMBULLIM, MAGAZINIM DHE TREGTIM TË LEKURAVE TË BAGËTIVE nuk gjendet në Shtojcën për procedurën e VNM paraprake ose të thëlluar të Ligjit Nr 10 440 për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis, datë 7.7. 2011. Në Përputhje me VKM nr. 419 date 25.06.2014 Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja, ky subjekt duhet të aplikojë për leje mjedisi të tipit B në AKM-Tirane.

Adresa e AKM-se, ku publiku mund të dergojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë Elektronike:

Adresa: Rruga "Sami Frasheri" Nr.4, Tirane, - Tel/Fax 04 2 371 237 www.akm.gov.al

Konform të të gjitha akteve dhe procedurave ligjore në fuqi i drejtohem AKM-Tirane për ndjekjen e procedurës konsultimit me publikun dhe palet e interesuara për aplikimin për LEJE MJEDISI TE TIPIT B.

ADMINISTRATORI
VLADIMIR GARULI

Celular; 0695141396

